

GJAKU QË SFIDOI PRANGAT. HISTORI DINJITETI, QËNDRESE DHE SAKRIFICE PËRBALLË DIKTATURËS

Pëllumb Dedndreaj
Instituti i Gjeoshkencave, Universiteti Politeknik
e-mail: dedndreup@yahoo.com

Abstrakt

Ky artikull trajton një nga periudhat më të errëta të historisë së Shqipërisë, përmes shembullit të një familjeje nga Nikaj-Mërturi që u përball me terrorin e regjimit totalitar komunist. Arsyeja themelore për ndërmarrjen e këtij studimi lidhet me mungesën e një njohje të plotë të rezistencës antikomuniste në veri të vendit, si edhe të vuajtjeve që përjetuan familjet të cilat guxuan ta sfidonin regjimin. Qëllimi i artikullit është të dokumentojë dhe të ruajë kujtesën historike të kësaj qëndrese, duke nxjerrë në pah sakrificat, dinjitetin dhe heroizmin e individëve që zgjodhën lirinë mbi jetën, si dhe dimensionin moral e shpirtëror të rezistencës së tyre të mbështetur në vlerat e nderit, besës dhe dinjitetit njerëzor. Në shërbim të këtij qëllimi, studimi mbështetet në një metodologji historiko-analitike cilësore, që ndërthur analizën e dokumenteve arkivore me burime familjare dhe literaturë bibliografike. Baza dokumentare përfshin dosjet e deklasifikuara të Sigurimit të Shtetit (p.sh. dosjet nr. 2351 dhe nr. 11), të cilat janë analizuar përmes verifikimit të burimeve, krahasimit të versioneve dhe kontekstualizimit politik të kohës. Përmes kombinimit të dokumenteve arkivore dhe dëshmiave familjare, studimi rindërton historinë e familjes Bub Matosh Dedndreaj, duke e paraqitur atë si një dëshmi të gjallë të qëndresës antikomuniste në malësitë veriore. Paralelisht, literatura historike mbi persekutimin politik ka shërbyer për të konfirmuar ose kundërshtuar të dhënat, duke mundësuar identifikimin e deformimeve ideologjike dhe ndërtimin e një tabloje historike më gjithëpërfshirëse. Gjetjet e studimit tregojnë se krahina e Nikaj-Mërturit u bë një vatër e fortë e rezistencës ndaj regjimit totalitar komunist, ku burrat dhe gratë e saj, si Bub e Bute Dedndreaj, dëshmuan heroizëm dhe besnikëri ndaj lirisë dhe nderit, përballë torturave, internimeve dhe vrasjeve. Historia e Nanë Butes, që sfidoi vdekjen për të shpëtuar djalin e saj nga kampi i internimit i Beratit, shndërrohet në një simbol të guximit dhe dinjitetit njerëzor. Ky artikull kontribuon në pastrimin e kujtesës historike kombëtare dhe në rishkrimin e një historie më të drejtë e më gjithëpërfshirëse, duke u dhënë zë atyre që u heshtën me dhunë e duke shërbyer edhe si mësim që brezat të kuptojnë çmimin e lirisë dhe qëndresën shpirtërore të shqiptarëve ndaj tiranisë.

Fjalë kyçe: *Nikaj-Mërturi, rezistenca antikomuniste, persekutimi politik, metodologji historiko-analitike, nderi dhe dinjiteti njerëzor.*

Objektivat

1. **Analiza e burimeve arkivore.** Identifikimi dhe shqyrtimi i dokumenteve të Sigurimit të Shtetit (veçanërisht dosjet nr. 2351 dhe nr. 11), për të kuptuar mënyrën sesi aparati shtetëror ushtronte dhunë dhe ndëshkim politik ndaj familjeve të krahinës Nikaj-Mërtur.
2. **Krahasimi me dëshmi familjare.** Ndërlidhja e burimeve zyrtare me rrëfimet dhe dokumentet familjare, për të evidentuar kontrastin midis ideologjisë së regjimit dhe përvojës reale të të përndjekurve, duke korrigjuar deformimet historike dhe duke ndërtuar një rrëfim të drejtë e të besueshëm.
3. **Theksimi i dimensionit moral dhe kulturor.** Evidentimi i qëndresës si mbrojtje e dinjitetit, besës dhe vlerave shpirtërore që përbëjnë identitetin e maleve shqiptare.
4. **Kontributi në kujtesën kolektive.** Bashkimi i historisë zyrtare, me kujtesën e gjallë të brezave, për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe akademik mbi pasojat e diktaturës dhe rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike si pjesë të identitetit kombëtar.

Hyrje

Gjatë periudhës së regjimit totalitar komunist në Shqipëri (1944–1990), pushteti ushtronte një kontroll të ashpër mbi jetën politike, shoqërore dhe kulturore të vendit. Përveç dhunës fizike, përndjekjes politike dhe internimeve, regjimi ushtroi ndikim mbi kujtesën kolektive, duke i kategorizuar njerëzit në “heronj” të regjimit dhe “armiq të popullit”. Shumë ngjarje që pasqyronin qëndresën, dinjitetin dhe vlerat tradicionale shqiptare, u heshtën, u shtrembëruan ose u zhdukën nga burimet zyrtare. Në këtë kuadër, krahinat e veriut, veçanërisht Nikaj-Mërturi, u bënë skena e një rezistence të vazhdueshme ndaj regjimit totalitar komunist. Familjet e kësaj zone ruajtën vlera të forta të bashkimit, dinjitetit dhe besës, duke refuzuar të dorëzoheshin përballë presionit shtetëror. Në qendër të këtij rrëfimi qëndron familja e Bub Matosh Dedndreaj, e cila përfaqëson tragjedinë dhe heroizmin e një brezi që pagoi një çmim të lartë për lirinë dhe integritetin e vet. Në këtë kontekst, historia e familjes Dedndreaj shndërrohet në një simbol të rezistencës dhe të sakrificës për vlerat më të thella njerëzore. Anëtarët e kësaj familjeje treguan një forcë të jashtëzakonshme përballë presionit të shtetit, ndarjeve të dhunshme të pronave dhe përpjekjeve për të shuar çdo shenjë të kujtesës së tyre. Kujtimet e tyre, rrëfimet e gjyshërve dhe dokumentet e mbetura, dëshmojnë jo vetëm për dhimbjen e pësuar, por edhe për kurajën dhe vendosmërinë e njerëzve që, në mënyrë të heshtur, refuzuan t’i dorëzoheshin errësirës ideologjike. Ky rrëfim nuk është thjesht një kronikë e ngjarjeve, por një përpjekje për të rikthyer zërin e atyre që historia zyrtare përpiqej ta heshtte, për të kuptuar sesi dinjiteti, besa dhe lidhjet familjare mund të qëndrojnë mbi çdo frikë dhe shtypje. Në këtë kuadër, përvoja e Nikaj-Mërturit dhe e familjes Dedndreaj bëhet një testament i përgjeshëm i qëndresës shqiptare dhe i forcës së shpirtit njerëzor përballë padrejtësisë.

Paralajmërimi i ardhjes së regjimit totalitar komunist (diktaturës).

Vendosja e regjimit totalitar komunist, apo “*bolshevizmit*”, - siç e quanin banorët e Nikaj-Mërturit dhe Dukagjinit, - nuk ishte e papritur. Kjo epokë ogurzezë ishte paralajmëruar që herët nga meshtarët dhe njerëzit e shkolluar. Pa kurrfarë droje, ata i shpreheshin popullit të vet se: “*Ka me ardhë një regjim që ka me pushkatue njerëzit ma të mirë dhe ma me vlera që kemi, për me mujtë me vendosë diktatin e tyne. Nuk ka me pasë kurrkush kurrgjë ma të vetën. Tokën dhe pasurinë ka me i marrë shteti, e buka për popullin ka me u nda në një prezore, e shumë shpesh ajo prezore s’ka me u çelë me ditë të tana, se s’ka me pasë bukë. Kanë me u mbyllë kishat dhe kurrkush s’ka me guxue me iu lutë Zotit. E në fund, ne priftërinjtë kanë me na burgosë, torturue dhe, në fund, na pret konopi*”. Dhe në fakt ashtu ndodhi. Fati i keq i shqiptarëve u përcaktua që larg, aty ku kishte lindur ideologjia bolshevike dhe ku gjithmonë ishin ngjizur dhe kishin marrë udhë plane ogurzeza në dëm të trojeve shqiptare. Pra, Shqipëria do të ndahej nga Perëndimi dhe qytetërimi, për t’u bërë pjesë e Lindjes, sipas planit famëkeq të Moskës, në bashkëpunim me sllavët në Ballkan. SHBA-të dhe fuqitë e mëdha të Evropës e kishin lënë Shqipërinë vetëm, në dorë të komunizmit. Sipas Rouz Uajlder Lejn (Rose Wilder Lane), gjatë njëzet shekujve, shqiptarët janë konsideruar pasardhës të mbetur të racës më të hershme ariane në Evropë. Për nga karakteri, temperamentit dhe zgjedhjet e tyre, ata i përkasin më shumë popujve të Perëndimit sesa fqinjëve të tyre sllavë në Ballkan.

Rezistenca e krahinës së Nikaj-Mërturit ndaj instalimit të regjimit totalitar komunist.

Nuk vonoi dhe ajo ditë erdhi. Një qeveri mizore po lidhte me shpejtësi nyjat e litarit që do vendosej në qafën e shqiptarëve. Në Tiranë kishte mbirë tirania, një sekt mizor që po përparonte përditë, duke shkëlmuar mbi gjakun e pafajshëm të atyre shqiptarëve që s’e dorëzonin lirinë. Po zhbëhej me shpejtësi gjithçka që shqiptarët ishin munduar të ruanin nga shekujt e mundimshëm të robërisë. Regjimi po përparonte me shpejtësi, kishte marrë nën pushtim thuajse gjithë vendin dhe, në fund, u erdhi radha maleve. Djajtë e kuq iu vërsulën malësorëve të këtyre dy krahinave me gjithë egërsinë, pa pikë mëshire e pa marrë parasysh asgjë mbi tokë, duke u sjellë njësoj si pushtues. Familjet më në zë të Nikaj-Mërturit filluan rezistencën, të vendosura për të mos u pajtuar kurrë me të keqen, me gjëmën që do t’i binte Shqipërisë dhe shqiptarëve. Udhëheqësit komunistë e dinin fort mirë se këto krahina nuk nënshtroheshin lehtë. Malësorët trima dhe fisnikë nuk u ishin përkulur osmanëve për pesë shekuj, edhe pse kishin paguar një çmim tepër të lartë. Ata e kishin kaluar jetën gjithmonë në luftë, herë me osmanët e herë me serbo-malazezët. Sulmi filloi. Në nëntorin e vitit 1944 u vërsulën me tërbim mbi Nikaj-Mërturin forca të shumta të Sigurimit, Brigada e VI sulmuese dhe forcat e ndjekjes, të cilat u pritën me pushkë në Qafën e Kolçit, pikërisht në kufirin ndarës midis Nikaj-Mërturit dhe Malësisë së Gjakovës. Aty u zhvillua një betejë e përgjakshme dhe pati të vrarë nga të dyja palët. Por ajo që tërhoi edhe më shumë regjimin e Tiranës ishte vrasja e komandantes Xhemile Shehu,¹ e cila ishte motra e Mehmet

¹ @gjata.com, “Qëndresa Antikomuniste e Nikaj-Mërturit në Qafën e Kolçit,” AL in Sweden, 15 nëntor 2018, <https://alinsweden.blog/2018/11/15/qendresa-antikomuniste-e-nikaj-merturit-ne-qafen-e-kolcit/>.

Shehut. Në këtë betejë ranë dëshmorë Babun Uka, Çun Kola, Martin Pali dhe Kol Zefi, burra trima e guximtarë që nuk e negocionin lirinë dhe ishin të vendosur të mos e çonin jetën e tyre në robëri e pa dinjitet. Kjo fitore e Nikaj-Mërturasve ishte e dhimbshme dhe e përgjakshme, por edhe e përkohshme. Pas disa kohësh përgatitjeje, nisi sërish furia e sulmeve mbi Nikaj-Mërturin, me forca më të shumta dhe armatime më të rënda. Egërsia e tyre i kalonte kufijtë e çmendurisë njerëzore: çdo kundërshtar duhej të vritej dhe krahinën duhej ta bënëin zap. Ata u riorganizuan, mbajtën krahinën të rrethuar dhe e mësënë sërish nga drejtime të tjera, duke hyrë në zemër të saj e duke vendosur një post-komandë që kontrollonte çdo familje me “za” në krahinë, çdo burrë apo grua që shihej si rrezik për regjimin. Ata rekrutuan njerëz pa nder e pa dinjitet, të cilët për turpin e tyre kishin shkelur çdo kod moral të trashëguar, që i kishte mbajtur të bashkuara familjet e kësaj krahine ndër breza. Çeta e burrave antikomunistë të Nikaj-Mërturit nuk kishte ndërmend të dorëzohej. Ata ishin të vendosur të qëndronin përballë regjimit deri në pikën e fundit, ndaj u rigrupuan dhe u vendosën nëpër male, në pika strategjike, për t’u bërë ballë sulmeve të vazhdueshme të forcave të Sigurimit.

Regjimi kërkonte sërish gjak.

Postëkomanda në Nikaj-Mërtur ushtronte dhunë dhe terror mbi popullin dhe ngado ishin vendosur grupe të armatosura me ushtarë e policë të etur për gjak. Kishin ardhur në krahinë dy burrat më gjakatarë e më të pashpirt që kishin shkelur ndonjëherë në ato anë: major Musa Daci dhe xhelati famëkeq Xhemal Selimi, që nuk kishte kurrfarë ndjeshmërie njerëzore dhe kënaqej kur plumbat e tij merrnin jetë e gjaku rridhte lumë. Pas çdo breshërie mbi trupat e njerëzve, të kënaqur me gjakun që gulçonte rrëke, fusnin dorën në xhep, nxirrnin arra dhe i thyenin në kondakun e automatikut, duke ngrënë si hienat e uritura kur kapin prenë. Ata nuk mund të ishin ndryshe, sepse ishin të besuarit e partisë dhe kishin një mision të qartë: të nënshtronin krahinën e Nikaj-Mërturit, duke e larë me gjak. Nuk humbën aspak kohë dhe thirrën një mbledhje në Kodrën e Bek Selimit, ku të gjithë meshkujt e krejt krahinës, 16 vjeç e lart, më datë 27 shtator 1946 duhej të paraqiteshin për dorëzimin e armëve. Dorëzimi i armëve ishte vetëm preteksti i masakrës së radhës mbi këtë popullsi, ku ata kishin planifikuar djallëzisht që populli i kësaj krahine të shihte me sy gjakun e familjarëve që do të rridhte lumë. Në atë mbledhje mungonte dikush që ishte pikasur nga xhelatët e sigurimit për t’u pushkatuar; për këtë arsye, mbledhja u shty për të nesërmen, më 28 shtator. Kjo datë ishte shumë e rëndësishme për krejt krishterimin, pasi kremtohej festa e Shën Mëhillit, një ditë e nderuar dhe e respektuar në këto anë, si askund tjetër në Shqipëri. Pra, mbledhja u shty për të nesërmen, më 29 shtator, ditën e Shën Mëhillit. Në mbledhjet e thirrura, nuk kishte shkuar dy herë burri i mençur, trim dhe fisnik, trashëgimtar i njërit prej trojeve më të mira të trashëguara ndër breza në malet e Malsisë, Fet Sadiku i Palçit, që për shkak të moshës kishte dërguar si përfaqësues djalin e tij. Kur djali u kthye në shtëpi dhe i tregoi Fetës se mbledhja ishte shtyrë për të tretën herë, Feta e kuptoi planin ogurzi. Me një shprehje fisnike, siç e karakterizonte gjithmonë dhe me mençuri e trimëri të pashoqe, tha: *“E di baba fort mirë pse asht shty prap sod mledhja. Pa shkue k’ta eshtën të mi në mbledhje ajo nuk bahet, se ata kërkojnë me çdo kusht kryet tem”*. Nata e Shën Mëhillit u festua nën terror; qirinjtë dhe uratat nuk e patën dritën dhe gëzimin si herët e tjera, sikur donin të paralajmëronin tragjedinë

e pashmangshme të së nesërme. Më 29 shtator, dita e Shën Mëhillit, të gjithë burrat e dy fiseve u mblodhën në heshtje të varrit, secili, duke pirë duhan dhe duke ndërruar kutitë sipas zakonit, shikonin njëri-tjetrin për të kuptuar nëse dikush dinte diçka, sikur zemrat ua ndienin tragjedinë që i priste. “Sahati i lig” kishte ardhur, dhe burrat e kësaj krahine do të shihnin tmerr me sy, edhe pse i ishin përgjigjur paqësisht thirrjes për bashkim. Pasi shpërndanë helm e vrer me tone të forta, mbi të gjithë popullsinë, vendosën t’i pushkatojnë Fet Sadikun dhe Ukë Çunin para krejt popullit të Nikaj-Mërturit, duke përgjakur Shën Mëhillin, i cili ishte festuar me gëzim shekuj me radhë në ato anë. Në mbledhje nuk kishte ardhur as Isuf Sadik Prebibaj, pasi ishte informuar nga një kumbarë se do të pushkatohej, për çka dy dite më vonë i dogjën shtëpinë. Edhe Ukë Çunit, pasi e pushkatuan, i dogjën shtëpinë dhe i burgosën vëllain. Edhe Shën Mëhilli, i cili njihej dhe besohej si shenjt i luftës shejtanin, nuk po mundej të qëndronte më përballë djajve të kuq. Ata e kishin mundur Shën Mëhillin dhe ajo datë nuk kurrë do të mundej më të festohej si më parë. Për këtë arsye, 29 shtatori 1946 do të mbahet mend përjetësisht si dita e Shën Mëhillit të përgjakur në Nikaj-Mërtur.

Dy muaj më vonë, me ndihmën e informatorëve faqezinj, që kishin tradhtuar bashkëkrahinorët e tyre duke u bërë palë me forcat komuniste, Sigurimi arriti ta zbulonte vendndodhjen e çetës së burrave antikomunistë të drejtuar nga Nik Sokoli, e cila ishte strehuar në Curraj të Epërm, një vend strategjik i zgjedhur për të pasur mbrojtje më të sigurt. Ata qëndronin në një stan, në Pikë të Currajt të Epërm, të armatosur dhe të vendosur të qëndronin deri në vdekje. Në postëkomandë mbërriti informacioni që zbulonte vendndodhjen e tyre, një pabesi e rëndë që përdohte kodin e nderit të këtyre malësorëve. Si rezultat, forca të shumta të Sigurimit, të ushtrisë dhe të Brigadës VI, u vërsulën drejt Currajve. Nga mesnata stani u rrethua dhe u qëllua me breshëri nga të gjitha llojet e armëve, duke u bërë thirrje për dorëzim dhe duke i cilësuar si tradhtarë. E gjithë nata ishte një ferr i vërtetë! Afër mëngjesit stani mori flakë nga plumbat dhe ata do të digjeshin të gjallë brenda tij. Por ishte trimëria e Mark Sadikut, ku me mitralozin e tij e çau rrethimin dhe ata vrapuan drejt ahishtës. I fundit, duke dalë nga dera e stanit, plagoset rëndë nga një plumb Pjetër Mehmeti, biri i Mehmet Shpendit, i pari i djalërisë së Shalës. Sipas besës së dhënë për të mos e lënë shokun në duart e Sigurimit, Mark Sadiku kthehet dhe i rri tek kryet nëpër flakët e plumbave që vinin nga të gjitha drejtimet dhe që nuk pushonin për asnjë çast. Duke u mundur t’i lidhë plagën dhe t’i ndalojë gjakun që i rridhte çurkë, në grahmat e fundit Pjetri hapë pak sytë dhe flet ngadalë.

“Mark Sadik ti kosh bekue

mos e hup jetën për mue

me majtë besën mos u lodh

se ky plum m`ka dalë boll”.

Kjo çetë burrash antikomunistë ishte e përgatitur për të vdekur. Ata e dinin se vdekja mund të ishte më afër se këmisha, e dinin se koha ishte e pamëshirshme dhe tashmë ishte bërë aleate e regjimit, por liria dhe dinjiteti i tyre peshonin më shumë se vdekja, më shumë sesa gjithë këto

male kreshnike që i kishin rritur. Ata ishin çeta e burrave më të fortë se shkëmbi, që s'donin t'ia dinin nga vinte vdekja. Pjesë e kësaj beteje ishin: Nik Sokoli, Mark Tunxhi, Shpend Sadiku, Mark Sadiku, Gjelo Noshi, Sadik Marku, Gjeto Marku, Kol Ndou, Bafti Ndou, Fran Ukshini, Pjetër Kuka, Halil Çuni, Nik Delia, Mark Shytani, Sokol Zefi, Sylë Martini etj. Ky ishte një çmim tepër i lartë, një padrejtësi e përgjakur, e papërligjur nga asnjë mendje e shëndoshë njerëzore. Megjithatë, regjimi nuk ishte ngopur me gjakun e këtyre malësorëve. Kërkonte t'u merrte lirinë dhe dinjitetin, duke synuar çdo kusht t'u shkatërronte edhe ato dy gishta nderi në ballë, që ata i kishin ruajtur dhe trashëguar ndër shekuj me mund e sakrifica të panumërta. Pas kësaj ngjarjeje nisën arrestimet, torturat dhe dhuna psikologjike e gjithanshme. Ata nuk tërhiqeshin nga marrëzia për të nënshtruar këtë popull fisnik, pasi ishte i fundit që po binte nën kthetrat e diktaturës. Krahina po binte përditë e më shumë në duart e djajve të kuq, por kishte ende shumë burra të vendosur që qëndronin dhe nuk donin t'i dorëzoheshin diktaturës. Një tjetër betejë e përgjakshme u zhvillua pak muaj më vonë në Markaj, në shtëpinë e Talush Palit, ku kërkonin kokën e Mark Tunxhit, por dështuan duke pësuar humbje të turpshme, pasi një malësor i vërtetë kurrë nuk e pranonte tradhtinë në shpinë të vet. Shtëpia e Talush Palit kishte u rezistuar mrekullisht të gjitha betejave dhe sfidave ndër breza, duke qëndruar e pastër si kristali, megjithëse me shumë sakrifica dhe humbje njerëzore.

Kulla e fundit e rezistencës.

Grupi i rezistencës antikomuniste Nikaj-Mërturas, i kryesuar nga Nik Sokoli, Mark Tunxhi, Shpend Sadiku dhe Ndue Noshi, kishte pësuar humbje të mëdha, pasi shumë nga shokët e tyre ishin vrarë dhe regjimi kishte marrë përparësi. Për këtë arsye, nëntë burra nga çeta e Nik Sokolit, të kryesuar nga Shpend Sadiku, që ishte daja i Bub Matoshit, u rigrupuan dhe u vendosën në Salcë, në kullën e Bub Matosh Dedndreajt, nga ku lidhnin dhe shkëmbenin informacion me grupe të tjera nëpër male, si dhe me një mision anglez që përpiqej t'i ndihmonte. Kjo kullë u kishte rezistuar shekujve dhe ofronte mbrojtje për shkak të pozicionit shumë të favorshëm gjeografik, por edhe falë burrave të saj, të cilët kurrë nuk kishin humbur asnjë betejë dhe që u bënë “bark e shpinë”, duke siguruar ushqim dhe strehim për plotë nëntë muaj në çatinë e kësaj kulle. Vështirësitë ishin të mëdha. Vendi vuante nga varfëria, pasi ishin vite të mungesës së bukës. Grupi antikomunist ishte etiketuar nga qeveria e Tiranës si “reaksioni i maleve” dhe forcat shtetërore i bashkuan sërish përpjekjet për eliminimin e tij. Vdekja dukej çdo ditë në horizont, si një hije e zezë që i ndiqte ngado.

Zbulimi i grupit dhe arratisja.

Në verën e vitit 1948 vendndodhja e këtij grupi u zbulua dhe strehimi i tyre nuk ishte më i sigurt. Alternativat ishin sosur, ndaj ata duhej të merrnin një vendim: ose të përballeshin gisht për gisht me forcat e ndjekjes, ose të çanin rrethimin dhe të arratiseshin me kë të mundnin. Ata vendosën të arratisen, si rruga më e mirë, për të shmangur më shumë gjakderdhje me vëllezërit e tyre

shqiptarë, ndonëse këtyre të fundit mendja u kishte marrë “arratinë” dhe i ishin nënshtruar ideologjisë bolshevike. Besa e Malësorit është shumë e fortë, ajo ka një fuqi të tmerrshme, ndaj për ta në çdo rrethanë ajo ishte e pathyeshme. Besnikëria tek malësoret është palca e nderit. Një anëtar i këtij grupi, Ndue Nosh Progni, që nuk arriti të arratisë, pak kohë më vonë u arrestua dhe u pushkatua pa gjyq dhe ende sot nuk i gjendet varri, me gjithë përpjekjet e pareshtura të familjes. Më 5 gusht 1948, pa dalë ende mirë drita, ata morën rrugën e arratisjes. Ishin tre burra të kësaj familjeje që e kishin kundërshtuar fort regjimin dhe kishin mbajtur e ushqyer rezistencën: Bub Matosh Dedndreaj, Pal Cek Dedndreaj dhe Mirash Ukë Dedndreaj. Së bashku me Marash Tush Prognin, Gjon Bal Prognin dhe Zef Deli Lekndreaj, antikomunistë të betuar, morën rrugën pa kthim, duke u larguar nga vendi dhe duke lënë pas në duart e djajve të kuq familjet e tyre, gratë dhe fëmijët e mitur. Ata morën rrugën nëpër male për të arritur në Theth, si pika më e mundshme për të kaluar kufirin. Por për të shpëtuar nga ndjekja, duhej të shpërndareshin në drejtime të ndryshme. Bubi, me një pjesë të grupit, mori një drejtim krejt tjetër, duhej të kalonte “gjallë a dekë” nga Curraj i Epërm, për një takim të fundit me njeriun më të dashur në jetën e tij: motrën e tij, Bjeshkën.

Pa zbardhur drita e ditës tjetër, u dëgjua trokitja në derën e kullës. Kur dera u hap, në atë prag dolën njëherësh Bjeshka Matoshja dhe Zef Isufi, nanë e bir, të shtangur në vend, pa mundur të nxirrnin asnjë fjalë nga goja. Zemrat e motrës dhe nipit e ndjenin thellë çfarë kishte ndodhur, edhe pse e dinin qysh më herët se kjo betejë, e nisur prej kohësh kundër regjimit, ishte pa kthim dhe do të kishte pasoja të rënda. U panë sy më sy, duke u marrë vesh pa folur asnjë fjalë; i dhanë bekimin njëri-tjetrit me një përqaftim të fundit dhe kurrë më nuk u panë. Koha nuk priste, ndaj Zefi e përcolli në një vend të sigurt, larg kullës së vet dhe larg fshatit, në male, duke e ditur se shumë shpejt Sigurimi do t’i trokiste në derë dhe pasojat do të ishin të pashmangshme. Në bjeshkët e Currajve u bashkua me Nik Sokolin dhe Shpend Sadikun, për të vazhduar nëpër male rrugën e vështirë drejt kufirit. Në malet e Dukagjinit u ribashkuan me grupin e dukagjinaseve, të cilët e kishin kundërshtuar regjimin me të gjitha format dhe mjetet, duke paguar për këtë një çmim tepër të lartë, siç ishin: Sadik Mark Shpendi, Gjeto Mark Shpendi, Prenda Mark Shpendi, Age Voci, tre bijtë dhe reja e Mark Sadikut, interpretuesit të njohur të Kanunit të Lekë Dukagjinit, burrit trim dhe të mençur që i peshonte fjala sa askujt tjetër në male. Kjo familje kishte përjetuar nga regjimi sjelljen kriminale, vrasjen e burrave të saj dhe terrorin. Me ta u bashkuan edhe Bajraktari i Shalës, Prelë Marku, së bashku me gruan e tij Zojë Sokolja, si dhe Mark Prela, Mark Alia, Ndoc Kola, Marash Kolë Hajdari, Mark Mëhill Pepsumaj nga Molla e Shoshit, Pashko Pjetrushit, Gjeloš Toma me gruan dhe motrën, si dhe Kol Lek Shyti.

Për këto male nuk kishte gjëmë më të madhe sesa largimi i këtyre familjeve. Burra dhe gra që në kohëra të vështira kishin mbajtur gjallë peshën e shqiptarisë. Tashmë në male grupi po shtoej çdo ditë e më shumë. Ata kishin bërë detyrën e tyre si burra të malësisë dhe si shqiptarë fort të mirë, kishin rezistuar sa kishin mundur që djajtë e kuq të mos mbillnin farën e keqe në këto anë. Por e keqja kishte marrë dhenë dhe ata nuk mundnin të bënin më asgjë për vendin apo për veten e tyre, përpos të largoheshin. Terreni i vështirë, netët e errëta dhe përkujdesja e vazhdueshme për të mos u pikasur nga forcave të shumta të ndjekjes e bënin rrugëtimin tepër të rrezikshëm. Edhe

pse ishte gusht, temperaturat në lartësi ishin të ulëta, sidomos natën dhe, për më tepër, veshja e pamjaftueshme dhe mungesa e ushqimit ishin pjesë e ferrit që duhej duruar. Pas disa ditësh ata arritën në Theth dhe u vendosën në Rragam, në një distancë të sigurt nga kufiri. Atje mbërritën edhe Kapiten Gjon Destanishta me Martin Camajn, dy miq dhe shokë të ngushtë, shumë të kërkuar nga Sigurimi, i cili këmbëngulte dhe përdorte dhunë e terror për t'i vënë kundër njëri-tjetrit. Dy ditë më vonë mbërritën edhe Vat Marashi nga Shoshi, Patër Ambroz Martini, Patër Daniel Gjeçaj, Lin Delia dhe të tjerë. Qëndruan disa ditë në pyllin e ahut, në pritje për të kaluar matanë. Bujaria e Ndre Cufës ishte e pashoqe dhe e pazëvendësueshme në ato ditë të vështira. Ai i furnizoi me bukë dhe ushqime sa mundi, por ata ishin shumë dhe mundësitë e tij ishin të pakta. Në Rragam qëndruan dy javë, duke kaluar netët në sheshet e mullarëve të dushqeve, të ngritura nga banorët për ushqimin e bagëtive për dimër, ku gjithnjë ishte dikush që nuk flinte, duke bërë roje për sigurinë e tyre. Më 25 gusht, në muzg, Ndre Cufa ngjitet në mal për t'u sjellë atyre atë pak ushqim që mund t'u siguronte. Por atë ditë kishte edhe një lajm të keq: forcat e Sigurimit dhe të ndjekjes i kishin diktuar dhe nga të katër anët kishte filluar rrethimi. Duhej kaluar kufiri sa më parë. Bashkë me ta, edhe vetë Ndreu, atë natë pa hënë, me dhimbje në shpirt dhe zemër, të copëtuar për familjet dhe vendin që po binte në ferrin e djajve të kuq, kaluan kufirin tridhjetë e tre burra dhe gra. E nesërmja i gjeti në Vuthaj e më pas në Guci. Në Za Stan u përballën me forcat jugosllave, ku u intervistuan dhe dhanë arsyet e arratisjes. Nik Sokoli dhe Gjon Destanishta u arrestuan menjëherë, ndërsa të tjerët i shpërndanë nëpër kampe. Në Jugosllavi qëndruan pesë vite, të cilat ishin vite vuajtjesh dhe mundimesh, me brengën e madhe për familjet dhe atdheun që kishin lënë pas. Pas një viti Nik Sokoli u lirua nga burgu dhe u bashkua me shokët, kurse Kapiten Gjon Destanishta u mbajt në burg, u torturua dhe u terrorizua deri në vitin 1951, kur u pushkatua në mes të kryeqytetit të shqiptarëve të Kosovës, Prishtinës. Para pushkatimit, fjalët e fundit të Kapiten Destanishtës ishin: *“Rrnoftë kombi shqiptar, rrnoftë flamuri kuq e zi”*.

Përpyjekjet për të marrë familjet

Përpyekja e parë

Gjatë kësaj kohe pati dy tentativa për të marrë familjet që kishin mbetur në Shqipëri. Në njërën prej tyre ata kaluan kufirin nga Gjakova dhe depërtuan thellë në territorin shqiptar, por shpejt u zbuluan nga Sigurimi dhe u ndoqën këmba-këmbës. Kudo ishin vendosur postblloqe dhe prita me ushtarë të armatosur. Në fshatin Markaj të Tropojës ishte vendosur një pritë afër urës, ku, duke kaluar urën në errësirën e natës, Shpend Sadiku u vra nga një breshëri automatiku e forcave të Sigurimit, ndërsa pjesa tjetër arriti të kthehej mbrapsht dhe të kalonte sërish kufirin për në Jugosllavi. Shpend Sadik Bushati, i vrarë mizorisht, u bë trofe i organeve të Sigurimit dhe forcave të ndjekjes. Partia organizoi një fushatë denigruese dhe terrorizuese, duke e lënë trupin e tij të vrarë për shtatë ditë mbi urën e Markajve dhe duke detyruar të gjithë popullsinë e Malësisë të shkonin dhe të shikonin sesi partia i ndëshkonte armiqtë. Pas shtatë ditësh kufoma u zhduk dhe

varri i tij nuk u gjet kurrë. Ajo derë fisnike, që kishte rezistuar gjithfarë pushtuesish dhe dallgësh historike, u mbyll përgjithmonë, pasi Shpendi ishte i vetmi dhe i fundit djalë i familjes.

Përpyjekja e dytë

Një vit më vonë, disa prej tyre u kthyen sërish në tentativë për të marrë familjet. Ata nuk e dinin se pjesa më e madhe e familjarëve të tyre ishte arrestuar dhe dërguar në kampet e internimit. Kësaj radhe ata hynë më thellë në territorin shqiptar, deri në zemër të Nikaj-Mërturit dhe natën vonë u vendosën në fshatin Palç, tek një i besuar i tyre. Pak para se të zbardhte drita u strehuan në pyllin e fshatit Salcë, mbi Leri, për të pritur errësirën e natës. Nga aty shikonin si në pëllëmbë të dorës gjithë Salcën dhe kodrat përreth, për ndonjë surprizë të mundshme. Një bari nga Salca, që atë mëngjes kishte dalë të kulloste dhitë, i kishte vënë re, por me një djallëzi të pashoqe kishte bërë sikur nuk i kishte parë. Ata menduan se ai ishte njeri besnik, pasi kishin kaluar bashkë të mirën dhe të keqen, por ai u tregua katil e shpirt zi, duke shkelur besën, nderin dhe kumbarinë e duke i spiunuar ata tek organet e Sigurimit, për çka menjëherë nisi rrethimi. Ajo ditë u kthye në një betejë të vërtetë midis “diversantëve”, - siç i quanin rëndom, - organeve të Sigurimit, forcave të ndjekjes dhe pushkatarëve anëtarë partie të Salcës dhe të dy fshatrave përreth. Në të gjitha anët e fshatit kishte grupe të armatosura që kishin zënë prita dhe kodrat flakëronin nga zjarri i armëve që qëllonin pa pushim. Kishte shkëmbime të vazhdueshme zjarri, ndonëse shumë qëllonin në ajër; disa nga që ishin fisnikë dhe disa nga frika e gjakmarrjes. Grupi i burrave antikomunistë, i sprovuar në betejë, u shpërnda në drejtime të ndryshme. Kudo dëgjohej thirrja: “Vritni kaçakët!” dhe i gjithë fshati ishte në tym dhe flakë baruti. Gjatë ikjes, Ndre Cufa rrëzohet dhe i shpërthen një granatë që mbante me vete, duke mbetur i vdekur në vend. Si gjithmonë, vendi i takimit për ata që do të shpëtonin nga rrethimi ishte kulla e Bub Matoshit. Si shenjë komunikimi për t’u ribashkuar, do të vendosej një jorgan nga ana e kuqe në gardhin e oborrit. Terreni i vështirë, por i njohur mirë prej tyre, i ndihmoi të largoheshin sërish drejt fshatit Brisë dhe më pas nëpër male, deri sa arritën përtej kufirit. Pas pesë vitesh në Jugosllavi, u lejuan të shkonin në Perëndim.

Pasojat në familje - Nëna që sfidoi regjimin.

Arratisja do t’ua ndryshonte përgjithmonë jetën dhe fatin, atyre dhe familjeve që lanë mbrapa. Ata do të jetonin përgjithmonë me kokën mbrapa, me shpirtin e plagosur dhe me zemrën e copëtuar nga malli, dashuria dhe pikëllimi, ndërsa për familjet e tyre do të fillonte kalvari i vuajtjeve dhe mundimeve, që kurrë nuk ishte parë e as imagjinuar. Lajmi për arratisjen u përhap shpejt, duke alarmuar Tiranën dhe tiranin! Tirani u ndie i fyer dhe i pa fuqishëm për t’i skllavëruar, torturuar dhe pushkatuar krerët e maleve dhe nisi inkuizicionin. Arratisja e tridhjetë e tre burrave dhe grave, dhe e dhjetëra të tjerëve ishte shenjë e qartë se liria në këto anë ka çmim tjetër, se çmenduria kishte kapur majat. Sigurimi u vërsul me tërbim mbi familjet e tyre. Dhuna dhe terrori që u ushtrua ndaj tyre ishte i papërmbajtshëm dhe i papërshkrueshëm. Ishte 7 shtatori dhe fisi po kremtonte Zojën e Mërturit, një festë që zgjaste tre ditë dhe ku merrnin pjesë miq,

bija, nipa dhe mbesa nga të gjitha fiset e Malësisë. Kjo festë u kthye thuajse në një mort për familjet e të arratisurve dhe për krejt fisin. Pasojat ishin të menjëhershme dhe të tmerrshme: pasuria e familjes që kishte strehuar rezistencën u konfiskua, u morën qetë, bletët, bagëtia, kazani i rakisë, mushku, gjysma e tokës, çdo gjë, me pretendimin se ishte pasuri e armikut të popullit dhe të partisë. Të njëjtat pasoja pësuan të gjitha familjet që tashmë ishin shpallur armike të partisë dhe pushtetit. Mes atyre që duhej të paguanin çmimin më të lartë ishte gruaja e Bub Matoshit, Bute Brahim Dedndreaj, bijë e Ndrevatajve nga Curraj i Epërm, një nënë që mbeti me tre fëmijë të vegjël, më i vogli shtatë muajsh dhe më i madhi gjashtë vjeç. Ajo kishte ushqyer dhe përkujdesur për nëntë muaj burrat antikomunistë të rezistencës. Për këtë “krim” u arrestua nga Sigurimi, së bashku me djalin e saj shtatë muajsh, Pjetër Dedndreaj, kurse dy fëmijët e tjerë i kishte fshehur në një kanion të thellë, midis Salcës dhe Brisës. Kalvari i vuajtjeve që sapo kishte nisur nuk merrte parasysh asgjë dhe nuk kishte as pikën më të vogël të mëshirës. Bashkë me nënë Buten u arrestuan edhe Prendë Mark Dedndreaj, me dy vajzat e mitura, Zojën dhe Lezen, si dhe Lulë Mirash Lekndreaj, me vajzën trevjeçare, Zojën. Lula ishte shtatzënë dhe vajza e dytë, Pashka, që u lind në kampin e internimit në Berat, humbi jetën kur ishte shtatëmuajshe, pas transferimit në kampin e Tepelenës dhe ende nuk e ka një varr. U arrestua edhe gruaja e Gjon Balës, me djalin e vetëm, Nduen, i cili vdiq, gjithashtu, në kampin e Tepelenës, pa lënë një varr. Për këta “engjëj armiq”, për këta martirë, u gëzua vetëm qielli, pasi qielli gëzohet më shumë për një martir sesa për nëntëdhjetë e nëntë priftërinj që bërtasin “hosana” qysh në fëmijëri. Fillimisht ata u mbajtën në Tropojën e Vjetër, për dy javë, pastaj u nisën drejt Kalasë së Beratit, ku ferri për “armiqtë e partisë” mori përmasa çnjerëzore. Tortura psikologjike, uria, mungesa e higjienës dhe trajtimi shtazarak ishin norma. Sëmundjet dhe epidemitë përhapeshin shpejt dhe vdekja ishte e përditshme. Fëmijët e vegjël, të cilët quheshin “engjëj armiq”, ishin të parët që rrëmbeheshin nga vdekja. Lumi Osum u bë shtrati i fundit për shumë prej tyre, pa një gur mbi varr, pa një emër dhe pa një lutje, sepse regjimi kujdesej për zhdukjen e provave të krimit. Pjetri i vogël u sëmur rëndë dhe shpresat për shërim apo mbijetesë ishin thuajse zero. Nana Bute, e pashpresë, e vuajtur dhe e pafuqishme, pa mëshirën e gardianëve dhe të askujt tjetër, vendosi të merrte një hap ekstrem: të arratisë nga kampi. Ajo u betua: *“Djalin, t’gjallë do ta çoj n’shipi, ose të dekun te vorret e t’parëve të tij”*.

Arratisja nga kampi i Beratit

Pas mesnate vuri në zbatim planin e saj për arratisjen nga kampi. Duke i shpëtuar syrit të gardianeve, me mundim të jashtëzakonshëm ajo këputi telat me gjemba dhe doli përtej rrethimit, duke mbajtur Pjetrin në krahë. Nuk njihte rrugën as vendin, por i shërbente si busull instinkti i nënës, vendosmëria, shpirti luftarak dhe besimi. Ecën vetëm natën për të shmangur kontrollat, pasi alarmi i arratisjes nga kampi ishte lëshuar kudo. Ditën fshihej nën ura ose në varreza, ku ndihej më e sigurt. Kur ndodhte që varrezat vizitoheshin edhe nga të tjerë, ulte kokën dhe qante pranë një varri që dukej më i ri. Në një rast, po qëndronte në një varrezë në Lushnje dhe një grua që po vizitonte varret e familjes së saj e vuri re dhe iu afrua për ta ngushëlluar. Nënë Butja, ende

me lot në sy, uli shaminë që të mbulonte sa të mundej fytyrën dhe nuk iu përgjigj nga frika se mos dialekti i saj mund të zbulonte identitetin dhe gruaja mund të njoftonte policinë. Pasi insistoi disa herë, gruaja u largua duke thënë: “E gjora grua, e ka lënë burri të katandisur si mos më keq, me fëmijë të vogël”. Mungesa e ushqimit e bënte rrugën jashtëzakonisht rraskapitëse, tej kapacitetit dhe limiteve të njeriut, por një nënë është në gjendje të bëjë gjithçka për ekzistencën, për nderin, për dinjitetin dhe për krijesën e saj. Frutat e egra dhe misrat në ara shërbenin si ushqimi i saj ditë e natë. Strukej në kaçube dhe vrojtonte me kujdes urat që do kalonte, pasi ato ishin pika kontrolli të rrezikshme. Pas dy javësh mbërriti në Shkodër, ku hapat e saj bëheshin edhe më të rrezikshëm, pasi qyteti ishte nën terror dhe vëzhgim të pandërprerë ditë e natë. Me shumë mundim dhe frikë të madhe kaloi Drinin dhe mori drejtimin për në malet e Dukagjinit, mal më mal, pa rrugë e pa strehë. Nuk kërkonte ndihmë në asnjë shtëpi apo fshat, nga frika se mund ta denonconin. Uria dhe lodhja i dukeshin si aleatë të regjimit, të vendosur ta mposhtnin Nënë Bute, por në çdo hap që i afrohej shtëpisë ajo merrte forcë për të ecur edhe më tej. Mënyra e vetme për të ushqyer djalin ishte grima e miellit që mbetej në rrethin e mullinjve. Ajo priste larg syve të njeriut që kishte shkuar për të bluar miellin e misrit dhe, sapo ai mbaronte e nisej për në shtëpi, shkonte e mblidhte ç’kishte mbetur. Miellin e trazonte me ujë në shuplakë të dorës për t’ia dhënë djalit, që ta mbante gjallë. Ishin vitet e mungesës së madhe, që në Malësi njihen si “zia e bukës”, ndaj ai pak miell kishte më shumë vlerë se ari. Ishte një udhëtim i çmendur për një grua me një fëmijë të vogël dhe të sëmurë, por ishte sfida më e madhe dhe më e denjë e jetës së saj. Asnjëherë ajo rrugë nuk i ishte dukur më e gjatë dhe asnjëherë ato male e ato fshatra të Dukagjinit nuk i ishin dukur më të largët e më të vështirë për t’u kaluar. Aleatët e saj ishin pafajësia, shpirti i saj i pamposhtur dhe orët e bleshkëve, të cilave u lutej pa pushim, në çdo hap që hidhte. Së fundi, doli përballë Salcës, ndaloi, uli djalin nga shpina dhe mori frymë thellë. Me sytë e njomur nga gëzimi që ia doli, hodhi një vështrim të gjithanshëm mbi fshat, falënderoi Zotin dhe nuk u zinte besë syve që më në fund kishte mbërritur në shtëpi. Edhe pse shtëpia dhe fshati ishin tashmë tokë e minuar, ajo nuk donte t’ia dinte kur e pyesnin: “Si ke ardhur? Si ke mundur të ikësh?” Ajo përgjigjej ftohtë dhe prerë: “*Pruna djalin mos me mi hupe eshtnat në Osum*”.

Arrestimi i dytë dhe internimi në Tepelenë

Lajmi për arratisjen e armikes së partisë u përhap menjëherë, ajo po kërkohej ngado dhe dihej se hakmarrja do të ishte e pamëshirë. Sigurimi nuk vonoi. Rrethuan kullën dhe kërkonin emrat e ndihmësve të saj, vendet ku ishte strehuar dhe familjet që i kishin dhënë ushqim. Ata nuk e imagjinonin forcën e kësaj gruaje, së cilës i ishin prekur fëmijët e saj. E arrestuan sërish, së bashku me djalin dhe e çuan në Tropojë të Vjetër, ku pritej urdhri për dërgimin e saj në një tjetër kamp internimi, këtë herë në Tepelenë. Në këtë moment kritik, shfaqet mësuesi Ndue Gjelo Progni, biri i një dere fisnike nga Nikaj-Mërturi. Ai ndërhyri tek organet e Sigurimit dhe u bë garant për jetën e Pjetrit. Falë tij djali shpëtoi pa u ndeshur edhe një herë me rrugën e mundimeve nëpër kampe të tjera internimi. Në Tropojën e Vjetër ishte qendra e dorëzimit të taksave dhe detyrimeve për çdo familje, ndaj aty u ndodh Linë Dedja, nëna e Prelë dhe Gjergj Sadrisë, e cila kishte shkuar

për të dorëzuar detyrimet që familja e saj kishte ndaj shtetit. Kjo grua e fortë, e prekur nga vuajtjet e familjes Dedndreaj, e mori Pjetrin në shpinë dhe e çoi në shtëpi, në Salcë, duke sfiduar rrugën e gjatë, lodhjen, rraskapitjen, urinë dhe frikën nga persekutimi, pasi po ndihmonte një foshnjë të shpallur armik. Nënë Butja u dërgua në kampin famëkeq të Tepelenës, aty ku mbaheshin familjet më fisnike shqiptare, ajka e kombit, që regjimi i shihte si kërcënim. Në kampin e Turanit gjeti edhe nënën fatkeqe të Gjeloash dhe Ndue Prognit, Sofinë, së bashku me dy rejat e saja, Zojën dhe Pulën, të cilat po vuanin pasojat e qëndresës së burrave të kësaj familjeje fisnike ndaj një regjimi gjakatar. Njërin nga djemtë e saj, Nduen, e kishin vrrarë, ndërsa Gjeloashin e kishin burgosur. Po në kampin e Tepelenës ishte dhe një grua heroinë, Drande Jakja, që ishte arrestuar më parë së bashku me vajzën dhe djalin e saj. Brenda trupit dhe shpirtit të tyre fshihej një tragjedi dhe një akt heroik që do të prekte thellë zemrat dhe ndërgjegjen e të gjithë shqiptarëve që kishin mbetur me pak ndërgjegje. Drandja ruante në jastëkun ku mbështeste kokën eshtrat e djalit të saj, që kishte vdekur. Ajo kishte shkuar fshehurazi natën në vendin ku gardianët kishin varrosur djalin, kishte hapur gropën dhe kishte mbështjellë eshtrat me rrobat e trupit të saj, të cilat më pas i ruante në jastëk gjatë gjithë kohës së internimit, për t'i sjellë pas lirimit në varrezat e të parëve të saj. Krimet monstruoze të diktaturës, nuk kanë njohur kufij. Ç'shembuj të tmerrshëm do të mund të jepen nga vetë familja ime, si dhe nga qindra familje të tjera në Malësi, sikur dhimbja prej kujtimeve të tilla të mos ua mbyllte gojën. Kane provuar në lëkurë dhunën, terrorin, dhimbjen, përbuzjen dhe vuajtjen. Nënë Butja vuajti padrejtësisht, përballoi me nder dhe dinjitet sfidat, mundimet dhe torturat çnjerëzore, por kurrë nuk u thye. Pas mbylljes së kampit, përpara se të kthehej pranë fëmijëve të saj në Salcë, e çuan në kampet e Lushnjës dhe më pas për disa muaj në Tiranë, ku pa pushim punonte me detyrim, nga mëngjesi, deri në darkë, në ndërtimin e pallateve.

Era e ardhjes së demokracisë.

Më 7 maj të vitit 1990 Shqipëria vizitohet për herë të parë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, H. P. De Kueljar, dhe merret premtimi për hapjen e Shqipërisë ndaj botës. Ky ishte çasti të cilin kishin një jetë që e prisnin, por jo! Më 12 maj, si të mos mjaftonte gjithë ai kalvar vuajtjesh, ato ditë të para shprese merr lajmin e kobshëm. Njeriu që kishte dashur më shumë në jetë, njeriu që i kishte munguar më shumë, kishte ndërruar jetë në Paris. Nuk i ishte thënë që kishin qenë më afër se kurrë. Punë ditësh dhe do kishin mundësinë për t'u parë e për t'u takuar pas më shumë se 40 vjetësh, por vdekja ishte e pamëshirshme. Fati sërish nuk ishte sërish me ta! Nënë Butë e goditi rëndë lajmi i vdekjes së tij, pasi gjithmonë kishte mbajtur gjallë shpresën se një ditë vuajtjet do merrnin fund dhe zemrat do të ishin sërish bashkë. E tronditur thellë, ajo qëndroi shumë e fortë, i mbështeti familjarët duke u dhënë forcë dhe siç kishte bërë gjithmonë, me forcën e nënës që nuk dorëzohet, tha: *“Ky kanka kanë fati ynë i zi, pra, duhet ta pranojmë pa u ligshTue. Diktatura po përmbysset, çmendunia njerëzore do marrë fund dhe liria për shqiptarët po vjen”*.

Epilog – Kthimi i eshtrave dhe rivarrimi i Bub Matoshit

Në gusht të vitit 1997, pas shumë vështirësish dhe pengesash, pa ndihmën e asnjë institucioni të shtetit shqiptar, që, përkundrazi, penguan dhe dekurajuan sa mundën, eshtrat e gjyshit tonë, Bub Dedndreaj, i ktheva në atdhe dhe i varrosa pranë të parëve tanë, duke sjellë një farë mbyllje kapitulli vuajtjesh të pamerituara dhe duke sjellë shpresë për të ardhmen e familjes. Ceremonia mortore u zhvillua sikur të kishte vdekur atë ditë, burra e gra nga të katër anët e Malësisë erdhën në mort. Nënë Butja qau, u mallëngjye, por edhe u gëzua që burri i saj më në fund do prehet i qetë në varrezat e të parëve të vet. Me lot në sy, me buzën që i dridhej më kapi dorën, më puthi në ballë dhe më tha: *“Të laqa bekue! U burrnove para kohe prej halleve e vuajtjeve, që nuk na i qoi Zoti, por robi, bane punë të madhe që e qove në fund amanetin e gjyshërve tu, e tash kurdo e ka shkruar Zoti, kam me vdekë rahat e me u varros nget tij. Ja ka vlej të çdo mund e sakrificë në këtë jetë, që po të la ty mrapa e në liri. Shqiptarët që jetuen diktaturën kanë boll çka me i kallzue brezave të ardhshëm, por edhe vetë Zotit ditën e gjykimit. Nuk din goja me kallzue ça asht ba në degët e brendshme, në kampet e internimit, në burgjet e randa. Asnjë mendje e shëndosh njerëzore nuk e beson e as që e çon nëpër mend atë çka bani komunizmi ndër shqiptarë. Shkoftë para Zotit!”*.

Dosja e Sigurimit të Shtetit Nr. 2351 e Bub Matosh Dedndreaj.

Menjëherë pas fillimit të punës për hapjen e dosjeve të Sigurimit famëkeq të shtetit, iu drejtua këtij autoriteti me një kërkesë për të parë se deri ku ka shkuar çmenduria e xhelatëve, si dhe për të ditur gjendjen e paraardhësve tanë, në raport me situatat e një përndjekjeje dhe persekutimi të vazhdueshëm, për gjysmë shekulli. Pas disa muajsh morëm zyrtarisht nga Autoriteti i Dosjeve dosjen me Nr. 2351, të deklasifikuar, të gjyshit tim të ndjerë Bub Matosh Dedndreaj. Nuk kishim asnjë dyshim për bëmat dhe tragjeditë që diktatura dhe xhelatët e Sigurimit të Shtetit, me falangat e tyre, i ka sjellë popullit shqiptar, por krijuam bindjen e thellë se sado i informuar të jesh, sado tragjedi dhe vuajtje të kesh kaluar, sado hetime, tortura, burgje e internime, prapë Sigurimi famëkeq i diktaturës ishte edhe më i keq sesa përshkruhet dhe mund të imagjinohet. Në dosje pasqyrohej përndjekja e të gjithë rrethit familjar, si dhe të gjithë njerëzit që kishin lidhje farefisnore apo miqësi me familjen tonë. Bub Matoshi ishte përndjekur në çdo vend ku ka jetuar dhe punuar nga njerëz të Sigurimit, si dhe spiunë të rekrutuar nga emigracioni, deri ditën që kishte ndërruar jetë. Në dosje u gjetën informacione sekrete të dhëna nga informatorë, si dhe dhjetëra letra që i kishte dërguar familjes, por që ishin mbajtur nga Sigurimi dhe që arritën në familje pas plotë shtatëdhjetë vitesh nga data e nisjes. Në vjeshtë të vitit 1948, menjëherë pas arratisjes, ishte përpiluar një raport ogurzi! Raporti i drejtohej Ministrisë së Brendshme dhe mban firmën e Shefit të Seksionit të Punëve të Brendshme të Tropojës, Kapitenit II Hasan Haxhija.

Raporti i dosjes

Në lidhje me bandat e armatosura që veprojnë në rrethin e Tropojës dhe aktivitetin e tyre kriminal gjatë muajit gusht të vitit 1948, ju njoftojmë si më poshtë: Kapiten Hasan Haxhija raporton se

situata në të gjithë Tropojën paraqitet e qetë, përveçse në krahinën e Nikaj-Mërturit. Ai thekson se puna e partisë ka ecur mirë dhe se elementi reaksionar nuk ka arritur të ndikojë tek popullsia, me parullat e veta, pasi masa është sqaruar nga shokët e partisë. Elementët kundërshtarë janë demaskuar dhe nuk kanë mundur të pengojnë zhvillimet, me përjashtim të zonës së Nikaj-Mërturit, e cila është e mbushur me banda. Gjatë këtij muaji, nga kjo krahinë janë arratisur gjashtë persona të konsideruar kriminelë: Bub Matoshi, Pal Ceka, Mirash Uka, Gjon Bala, Marash Tushi dhe Zef Delia nga Salca. Sa i takon ndikimit politik të këtyre bandave në krahinën e Nikaj-Mërturit, ai ka qenë i dukshëm dhe në favor të tyre. Kriminelët janë mbështetur dhe kanë gjetur strehë në këtë zonë. Elementi kundërshtar është i përgatitur dhe pret çdo ditë ndryshimin e situatës, pa marrë në konsideratë nëse ekziston apo jo pushteti qeveritar. Sa u përket masave të ndërmarra në këtë krahinë, Komiteti i Partisë dërgoi përfaqësuesit më të aftë për t'ia sqaruar popullit, por këto përpjekje nuk dhanë rezultat, pasi banorët nuk marrin pjesë në takime. Edhe anëtarët e partisë në atë krahinë u tronditën dhe u ndikuan nga elementët reaksionarë. Për të gjitha këto të vërejtura, ne njoftuam organet e pushtetit që t'i japin rëndësi maksimale kësaj krahine, por deri tani nuk ka pasur asnjë efekt politik. Planet e pushtetit nuk zbatohen më atje. Ne propozojmë që në krahinën e Nikaj-Mërturit të dërgohet një forcë operuese me mandat të qartë për të kryer një aksion të ashpër, që të qërohen të gjithë elementët e dyshimtë dhe të shkatërrohen qendrat e bandave kriminale. Përveç këtij propozimi nuk kemi zgjidhje tjetër, sepse situata në këtë krahinë nuk mund të trajtohet ndryshe. Pra, kërkohej formimi i një skuadre ekzekutuese të dedikuar për krahinën e Nikaj-Mërturit. Duke shqyrtuar këtë dosje, del i qartë ky përfundim: Nikaj-Mërturi, familja jonë, si shumë familje shqiptare, pagoi një çmim tepër të lartë, por, duke parë këtë raport, si dhe dokumente të tjera të zyrtarëve të Sigurimit të Shtetit, si dhe të spiunëve të shpërfytyruar, gjërat mund të shkonin shumë më keq. Të gjitha dokumentet që Sigurimi i Shtetit ka depozituar në adresë të pjesëtarëve të familjes së Bub dhe Bute Dedndreaj, në një betejë gjysmë shekullore brenda dhe jashtë Shqipërisë, na bëjnë të ndihemi krenarë dhe ballëlartë për qëndrimin e tyre. Një betejë tejet e vështirë, e dhimbshme deri në palcë, por faqebardhë, qëndrim i kristaltë, i palëkundur përballë dhunës dhe presionit, si drita e diellit. Diktatura shkatërroi gjithçka të mirë që kishim ruajtur me mundë e sakrifica të panumërta dhe mbolli farën e urrejtjes, që ka mbirë kudo në tokën e zhuritur të shqiponjave dhe që e ka ndarë këtë popull përgjithmonë, ndoshta për të mos u bashkuar më kurrë. Era e gjakut, terrorit, vuajtjeve dhe dhimbjeve duan dekada për t'u davaritur.

Konkluzionet e studimit.

- Ndriçimi i historisë së lënë në hije: Studimi dokumenton qëndresën e familjeve të krahinës së Nikaj-Mërturit ndaj regjimit totalitar komunist, duke përdorur një kombinim të burimeve arkivore dhe dëshmime familjare, si dhe tregon se historia zyrtare e periudhës ishte shpesh e shtrembëruar ose e manipuluar ideologjikisht.
- Rezistenca si akt moral dhe kulturor: Veprimtaria e popullsisë lokale nuk ishte sporadike, por një akt i qëndrueshëm moral, kulturor dhe shpirtëror, i bazuar në vlerat e besës, nderit dhe dinjitetit njerëzor, që përfaqësojnë thelbin e identitetit të maleve shqiptare. Figura si

Bub dhe Bute Dedndreaj simbolizojnë këtë qëndresë dhe mbrojtjen e lirisë përkundrejt frikës dhe dhunës së regjimit.

- Kontrasti midis burimeve zyrtare dhe kujtesës familjare: Krahësimi i dokumenteve shtetërore, me rrëfimet dhe kujtesën familjare, evidentoi diferencat e thella midis propagandës dhe realitetit të përjetuar, duke zbuluar mekanizmat e terrorit dhe përpjekjet e popullsisë për të mbijetuar me dinjitet.
- Rëndësia e kujtesës kolektive: Dëshmitë gojore dhe dokumentet familjare plotësojnë boshllëqet e arkivave zyrtare dhe të historiografisë së censuruar, duke u bërë një burim i pazëvendësueshëm për rindërtimin e së vërtetës historike dhe për ruajtjen e kujtesës kolektive.
- Vlerësimi moral dhe identitar: Rindërtimi i historisë së rezistencës shqiptare është një akt drejtësie morale dhe identitare, që ndihmon në pastrimin e kujtesës kombëtare dhe në nderimin e brezave që u sakrifikuan për liri dhe dinjitet.
- Përgjegjësia e brezit të sotëm: Kujtesa historike nuk është thjesht një reflektim mbi të shkuarën, por edhe një përgjegjësi për të ruajtur të vërtetën, për të ndriçuar plagët e haruara dhe për të ndërtuar një të ardhme mbi themelin e së vërtetës dhe të dinjitetit njerëzor.

Sugjerime dhe Rekomandime.

- 1) Të ruhet dhe të theksohet trimëria, dinjiteti dhe sakrifica e popullit të Nikaj-Mërturit, duke nxjerrë mësim mbi rezistencën, besën dhe solidaritetin familjar, si mesazhe morale për brezat e sotëm.
- 2) Të përdoret një stil narrativ, që ndërthur faktin historik me rrëfimin, duke ruajtur qartësinë kronologjike dhe koherencën e ngjarjeve.
- 3) Të përfshihet një përfundim reflektues mbi ndikimin e këtyre ngjarjeve në identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kulturore, për të lidhur historinë lokale me vlerat më të gjera të shoqërisë shqiptare.
- 4) Të shqyrtohet mundësia e shtimit të elementeve vizuale, si harta ose ilustrime të thjeshta, për të lehtësuar kuptimin dhe vizualizimin e ngjarjeve historike.

Bibliografia

- Literatura

1. Progni, Dodë. *Malësorët dhe liria, shqyrtime historike*. Shtëpia botuese Geer, 2023.

2. Progni, Dodë, dhe Zef Doda. *Nikaj-Mërturi: Vështrim Historik*. Shkodër: Shtypshkronja “Shtjefni,” 2003. ISBN: 999-27-826-4-1.
3. Sadiku, Prenda Mark. “Si u arratisa së bashku me At Danjel Gjeçajn, Martin Camajn e tjerë.” Radi&Radi, 22 korrik 2020. <https://www.radiandradi.com/tag/prenda-mark-sadiku/>.
4. Wilder Lane, Rose. *Majat e Shalës: Një kronikë e disa udhëtimeve midis fiseve malësore të Shqipërisë*. Tiranë: Shtëpia Botuese “Dituria,” 2004. ISBN 978-99927-59-49-6.

- Materiale arkivorë

1. Dosja Nr. 11 viti 1953. Arkivi i Ministrisë së Brendshme.
2. Dosja e Sigurimit të Shtetit Nr. 2351 e Dedndreaj Bub.

- Webfaqe

1. @gjata.com. “Qëndresa Antikomuniste e Nikaj-Mërturit në Qafën e Kolçit.” AL In Sweden, 15 nëntor 2018. <https://alinsweden.blog/2018/11/15/qendresa-antikomuniste-e-nikaj-merturit-ne-qafen-e-kolcit/>.
2. Kujto.al - Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit. “Zoje Mhilli.” <https://kujto.al/personat/zoje-mhilli/>.
3. Kujto.al - Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit. “Zoje Progni.” <https://kujto.al/personat/zoje-progni/>.

- Rrëfime

B. M Dedndreaj, Intervistë video personale mbi sfidat e jetës, komunikim personal, 11 Janar 1990.
 Rrëfime personale. - Bute Dedndreaj, Gjok Dedndreaj.
 Rrëfime personale të përditshme. - Bute Dedndreaj.
 Rrëfim mbi diskutimet e priftit Patër Gega, komunikim personal, Shtator 1960. - Gjokë. P.

- Dokumente të ndryshme

- TVSH - Informacion Publik.
- Kronike e TVSH. Gusht 1997.